



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

|                                       |           |                  |                   |
|---------------------------------------|-----------|------------------|-------------------|
| Pranuar - Pranimja Me Datë 28-02-2025 |           |                  |                   |
| Nr. Dokumentit<br>Qaq. Ibb.           | Qaq. Ibb. | Shtesë<br>Pisheq | Vlera<br>Vrednost |
| 02-                                   | 052/02-   |                  | 169               |



## RAPORTI I PUNËS

**NGA: ZYRA PËR INFORMIM DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN-VITI**  
**PËR: PERIUDHA JANAR-DHJETOR 2024**

Gjatë vitit 2024, respektivisht periudhës janar-dhjetor, Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun (ZIMP) e Komunës së Vitisë, ka qenë e angazhuar në informimin sa më objektiv dhe të shpejtë për zhvillimet aktuale të Institucioneve komunale.

Gjatë kësaj periudhe, ZIMP ka pasqyruar dhe publikuar në Web faqen e komunës [kk.rks-gov.net/viti](http://kk.rks-gov.net/viti) lajme, aktivite si dhe dokumente në interesin publik. Megjithatë uebfaqet e komunave që janë nën menaxhimin e nivelit qendror edhe gjatë kësaj faze kanë pasur probleme të theksuara që kanë ndikuar në mos publikimin me kohë të dokumenteve të ndryshme megjithatë me qëllim të informimit sa më masiv të qytetarëve tanë kemi vazhduar të shfrytëzojmë llogarinë në rrjetin social Facebook. Po ashtu jemi përgatitur edhe për kalimin nga uebfaqeja e vjetër në të rejen : [viti.rks-gov.net](http://viti.rks-gov.net)

- Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, gjatë kësaj periudhe ka publikuar dokumente mbi procedurat e konkurrimit dhe pranimit në punë.
- Nga procedura e prokurimit janë publikuar dokumente të shumta përfshirë këtu: 34 kontrata të nënshkruara.
- Janë publikuar gjithashtu edhe 189 Njoftime publike, 55 Vendime të Kuvendit Komunal, 36 Vendime të Kryetarit të Komunës, të gjitha draft dokumentet të cilat janë paraparë të shqyrtohen në Komitetin për Politikë e Financa dhe Kuvendin Komunal.
- Po ashtu janë publikuar edhe disa Plane e Raporte si dhe Dokumentet të cilët ndërlihdën me shpenzimin e parasë publike.

- Një bashkëpunim të ndërsjellët dhe shumë të mirë, kemi pasur me mediat lokale dhe ato qendrore. Përmes adresave elektronike, gjitha mediave të shkruara, elektronike dhe agjencive të lajmeve u janë dërguar lajmet për ngjarjet nga komuna e Vitisë edhe përmes fotografive.
- Zyra për Informim publik ka përcjell gjitha aktivitetet e kryetarit të komunës, apo edhe zyrtarëve të tjerë komunal në terren.
- Pritjen e delegacioneve vendore dhe të huaj në komunën tonë.
- Në kuadër të zyrës janë bërë specifikimet e shpenzimeve për publikime: Shpallje, Konkurse, tenderë, Njoftime etj.
- Zyra për Informim ka marrë pjesë pothuajse në të gjitha trajnimet, punëtorit dhe mbledhjet e ndryshme për ndryshimin e pakos ligjore për Transparencë Janë mbajtur edhe dy takimet e rregullta të kryetarit të komunës, njëra në gjashtëmujorin e parë dhe njëra në gjashtë mujorin e dytë.

Në Zyrën për informim dhe Marrëdhënie me Publikun, janë të angazhuar 2 zyrtarë Agron Abazi e Mustafë Mehmeti ndërkaq staf mbështetës është Blerina Luzha Muharremi.

Viti, 13.02.2024

Zyra për Informim Publik

Agron Abazi,  
Mustafë Mehmeti,  
Blerina Luzha Muharremi


